



01 Nr. 385/26 Dt. 14.08.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi


Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Kujtim Gashit, nënkryetar i Komunës së Prizrenit dhe Islam Ukajt, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit, bazuar në ftesën e CEO shpk-Congress and Event Organization, për pjesëmarrje në vizitën profesionale në Frankfurt “AMI Compounding & Recycling Expo Europe 2026” i cili do të mbahet në Frankfurt të Republikës së Gjermanisë, nga data 23 shtator 2026 deri me 24 shtator 2026, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe pjesëmarrjes sipas faturës me nr: 260821, ushqimit, pagesën e mëditjeve si dhe të shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurit.
2. Nisja (shkuarja) zyrtare bëhet me datë 23 shtator 2026, ndërsa kthimi me 26 shtator 2026.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës- pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
4. Obligohen të lartcekurit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurve,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.